

1 E enjte, 14 dhjetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Aktgjykim i Apelit]

4 [Apeluesi hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.31

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirëmengjes
7 dhe mirë se erdhët të gjithë.

8 Z. Sekretar, a mund t'ju lutem të paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmengjes, të nderuar
10 Gjykatës, çështja KSC-CA-2023-02, Prokurori i Specializuar
11 kundër Salih Mustafës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Shoh që z. Mustafa është i pranishëm në sallë të gjyqit.

15 Z. Mustafa, a e ndiqni seancën në një gjuhë që e kuptoni?

16 APELUESI: Po.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
18 Faleminderit.

19 Tani do t'ju kërkoj palëve dhe Mbrojtëses së Viktimave që
20 të prezantohen, do të fillojmë me avokatët e z. Mustafa.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
22 Gjykatës. Mirëmengjes. Mbrojtja sot përfaqësohet nga unë,
23 Julius Von Bone, mbrojtësi kryesor; z. Fatmir Pelaj, hetues;
24 dhe në sallë i pranishëm është z. Mustafa. Faleminderit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Tani fjalën e ka Zyra e Prokurorit të Specializuar.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
4 Gjykatës. Mirëmëngjes, të gjithëve në sallë dhe jashtë sallës
5 së gjyqit. Prokuroria është e përfaqësuar sot nga Kimberly
6 West, Prokurorja e Specializuar; Julie Mann, që është
7 Administratore e Lëndës; Nico Baarlink, që është
8 Ndhmësprokuror; dhe nga unë Cezary Michalczuk, Prokuror.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Tani fjalën ja jap Mbrojtësja e Viktimave.

12 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
13 Mirëmëngjes, të gjithëve në sallë dhe jashtë sallës. Viktimat
14 pjesëmarrëse sot janë të përfaqësuara nga unë Anni Pues, dhe
15 nga Breshtje Vossenber, bashkëmbrojtëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Tani ja jap fjalën Zyrës Administrative.

19 ZNJ. DONLON: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
20 Fidelma Donlon, Administratore, Gjykatëse.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Më është
22 thënë që ka një fotograf që don të bëjë fotografi. A ka? I
23 keni bërë tashmë fotografitë? Është bërë?

24 [Paneli i Apelit dhe Sekretari i Gjykatës
25 këshillohen]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] A ju duhet
2 autorizim prej për të bërë fotografitë? Atëherë po ju
3 autorizoj që t'i bëni këto fotografi.

4 Faleminderit.

5 Për hir të procesverbalit, unë jam Michele Picard,
6 Kryegjykatëse në këtë çështje, dhe kolegët e mi Gjykatës, në
7 të djathtë Kai Ambos, dhe në të majtën time Nina Jorgensen.

8 Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit është mbledhur sot
9 për të shqiptuar aktgjykimin e apelit në çështjen gjyqësore
10 Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës. Ky aktgjykim
11 shqiptohet publikisht në emër të popullit të Kosovës dhe në
12 prani të të akuzuarit.

13 Kjo përmbledhje përmban pikat themelore të apeluara dhe
14 konstatimet kryesore të Panelit të Apelit dhe nuk është pjesë
15 e aktgjykimit zyrtar dhe autoritativ të apelit. Aktgjykimi me
16 shkrim është i vetmi dokument autoritativ i konstatimeve të
17 Panelit të Apelit. Aktgjykim i apelit do të vihet në
18 dispozicion në formë elektronike pas kësaj seance. Një kopje e
19 legalizuar e versionit në anglishte të aktgjykimit të apelit
20 do t'i jepet z. Mustafa sot, dhe versioni në gjuhën shqipe do
21 t'i jepet kur të jetë gati.

22 Dhomat e Specializuara u krijuan në lidhje me akuza të
23 rënda për trajtim çnjerëzor, vrasje të personave, dhe krime të
24 tjera të rënda të kryera gjatë dhe pas konfliktit të armatosur
25 në Kosovë midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000.

1 Ky aktgjykim i apelit shënon një moment të rëndësishëm
2 për Dhomat e Specializuara pasi është aktgjykimi i parë i
3 apelit në një çështje për krime lufte në këtë Gjykatë. Është
4 një hap i rëndësishëm drejt vendosjes së drejtësisë për
5 viktimat dhe llogaridhënies.

6 Ky aktgjykim trajton apelin kundër konstatimeve të Trupit
7 Gjykues në lidhje me përgjegjësinë e z. Mustafa, komandant i
8 njësitit gueril BIA, një njësit i Ushtrisë Çlirimtare të
9 Kosovës, ose UÇK për krime të kryera në kompleksin e Zllashit
10 në Kosovë, më tej do të përmendet si kompleksi i ndalimit në
11 Zllash afërisht ndërmjet 19 prill 1999 dhe fundit të prillit
12 1999.

13 Me 16 dhjetor 2022 Trupi Gjykues shpalli aktgjykimin në
14 të cilin e shpalli z. Mustafa fajtor për tri akuza për krime
15 lufte. Ai u shpall fajtor për krimet e luftës të ndalimit
16 arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, Pikat 1, 3 dhe
17 4; dhe i pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor,
18 Pika 2. Trupi Gjykues e dënoi z. Mustafa me dënim të njehsuar
19 prej 26 vjetësh burgim në të cilin llogaritet koha e kaluar në
20 paraburgim.

21 Gjatë shqiptimit të dënimit, Trupi Gjykues theksoi se z.
22 Mustafa po gjykohej për përgjegjësinë e tij individuale dhe se
23 në këtë proces në asnjë moment nuk po gjykohej Ushtria
24 Çlirimtare e Kosovës.

25 Trupi Gjykues konstatoi se afërsisht midis 1 prill 1999

1 dhe rreth 19 prill 1999 në kompleksin e ndalimit në Zllash që
2 ishte bazë e njësitit gueril BIA në Zllash, të paktën gjashtë
3 personave dhe iu hoq liria nga anëtarë të BIA-s që ishin nën
4 kontrollin dhe pushtetin e komandantit të BIA-s z. Mustafa.

5 Trupi Gjykses konstatoi se kjo ndodhi në kontekstin e
6 konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe
7 forcave serbe.

8 Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se gjatë të njëjtës
9 periudhë kohore z. Mustafa dhe anëtarë të tjerë të BIA-s nën
10 pushtetin e tij i mbajtën të ndaluarit në kompleksin e
11 ndalimit në Zllash në kushte ndalimi çnjerëzore dhe
12 poshtëruese dhe i keqtrajtuan rregullisht si fizikisht dhe
13 psikologjikisht me qëllim marrjen e informacionit ose të
14 deklaratave pranuese prej tyre dhe/ose për t'i ndëshkuar,
15 frikësuar, detyruar dhe/ose diskriminuar për arsye politike.

16 Së fundi, Trupi Gjykses konstatoi se personi i përmendur
17 si viktima e vrasjes së paligjshme u vra "afërisht ndërmjet 19
18 prill 1999 dhe fundit të prillit 1999", si rezultat i
19 veprimeve dhe mosveprimeve të z. Mustafa dhe vartësve të tij
20 të BIA-s.

21 Z. Mustafa dorëzoi apel kundër verdikteve të fajësisë
22 sipas Pikave 1, 3 dhe 4 të aktakuzës dhe një numri
23 konstatimesh të Trupit Gjykses të bëra në lidhje me to.

24 Z. Mustafa kërkoi që Paneli i Apelit të prapësojë
25 verdiktet e fajësisë dhe të shpallë vendim pafajësisë ose si

1 alternativë t'ia kthejë çështjen Trupit Gjykses ose të
2 zvogëlojë dënimin e dhënë.

3 Z. Mustafa nuk apeloj Urdhrin për Zhdëmtim të lëshuar nga
4 Trupi Gjykses më 6 prill 2023, në të cilin tetë viktimave
5 pjesëmarrëse në proces iu akorduan dëmshtëpërblime.

6 Paneli i Apelit dëgjoj para parashtrimet gojore të palëve
7 dhe Mbrojtëses së Viktimave më 26 dhe 27 tetor 2023. Në apelin
8 e tij, z. Mustafa përfshiu nëntë pika në 51 nënpika, në të
9 cilat ai parashtroj argumentime në lidhje me pretendimet e tij
10 për gabime juridike dhe faktike si dhe gabim për caktimin e
11 dënimit të bëra nga Trupi Gjykses.

12 Paneli i Apelit së pari i referohet standardit të
13 shqyrtimit të apeleve kundër aktgjykimeve të Trupit Gjykses
14 sipas nenit 46 të Ligjit. Paneli i Apelit mund të lërë në
15 fuqi, prapësojë ose ndryshojë aktgjykimet e Trupit Gjykses dhe
16 të marrë masa të përshtatshme për arsyet vijuese: Gabim
17 juridik që zhvlerëson aktgjykimin, gabim faktik që ka
18 shkaktuar gabim gjyqësor ose gabim në përcaktimin e dënimit.

19 Për arsyet e shtëjelluara më gjerësishtë në aktgjykimin e
20 apelit, Paneli rikujton diskrecionin e gjerë të Trupit Gjykses
21 për vlerësimin e provave dhe përcaktimin e dënimit të
22 përshtatshëm. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se nuk do t'i
23 përmbysë lehtësishtë konstatimet faktike të Trupit Gjykses
24 sepse Trupi Gjykses është në pozitën më të mirë për dëgjimin,
25 vlerësimin dhe peshimin e dëshmimeve të paraqitura gjatë

1 gjykimit, përveçse kur vlerësimi i Trupit Gjykues është
2 tërësisht i gabuar.

3 Gjithashtu, Paneli i Apelit nuk do të ndryshojë dënimin e
4 dhënë nga Trupi Gjykues përveçse kur bërë gabim të dallueshëm
5 në ushtrimin e diskrecionit të vet ose nuk ka zbatuar
6 dispozitat ligjore përkatëse.

7 Para se të bëj një përmbledhje të konstatimeve të veta
8 Trupi Gjykues dëshiron të nënvizojë se në disa prej pikave të
9 apelit, z. Mustafa nuk arriti t'i mbështeste argumentet e tij
10 me jurisprudencën përkatëse, nuk ka evidentuar konstatimet
11 konkrete të Trupit Gjykues të cilat kundërshton, as u është
12 referuar paragrafëve përkatës të aktgjykimit, krahas mangësive
13 të tjera.

14 Ndonëse, në parim, mangësi të tilla përlligjnin rrëzimin e
15 menjëhershëm të pikës përkatëse të apelit, Paneli i Apelit në
16 disa raste ka vendosur përjashtimisht t'i shqyrtojë ato për të
17 qenë i drejtë me të akuzuarin dhe në interes të drejtësisë. Në
18 raste të tjera, Paneli i Apelit i ka rrëzuar menjëherë këto
19 argumente pa e shqyrtuar thelbin e tyre.

20 Vlerësimi i Panelit të Apelit për këto raste shtjellohet
21 në gjerësisht në aktgjykimin e apelit.

22 Paneli tani do të përmbledhë konstatimet kryesore në
23 lidhje me Pikat 1 dhe 2 të apelit të z. Mustafa.

24 Së pari, Paneli do të trajtojë pretendimin për gabim
25 juridik lidhur me cilësimin që Trupi Gjykues i bën konfliktit

1 në Kosovë në periudhën përkatëse dhe më pas do të trajtojë
2 pretendim për gabim faktik në lidhje me, së pari, pranimin
3 prej Trupit Gjykses të disa provave dhe mbështetjen e tij në
4 to; së dyti, konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me
5 vendimin e kryerjes së krimeve; tre, vlerësimin e Trupit
6 Gjykses për dëshmitarët; dhe katër, konstatimet e Trupit
7 Gjykses në lidhje me mbrojtjen përmes alibisë të z. Mustafa.

8 Së pari, nën Pikën 1A të apelit, z. Mustafa kundërshtoi
9 cilësimin prej Trupit Gjykses të konfliktit në Kosovë gjatë
10 periudhës së aktakuzës si konflikt i armatosur jo-
11 ndërkombëtar. Ai parashtroi se ky cilësim i gabuar e bënte të
12 pavlefshëm aktgjykimin duke qenë se verdiktet e fajësisë së
13 tij për krime lufte bazoheshin në nenin 14(1)(c) të Ligjit.

14 Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses zbatoi
15 kriteret e sakta për vlerësimin e ekzistencës së konfliktit të
16 armatosur jo-ndërkombëtar në Kosovë gjatë asaj kohe. Z.
17 Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykses gaboi në
18 konstatim se nga maji 1998 UÇK-ja kishte karakteristika të
19 mjaftueshme të një grupi të armatosur të organizuar që ishte
20 në gjendje të përfshihej në një konflikt të armatosur jo-
21 ndërkombëtar.

22 Paneli i Apelit rrjedhimisht konstaton se z. Mustafa nuk
23 ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykses ka gabuar dhe
24 rrjedhimisht rrëzon Nën-pikën 1A të apelit.

25 Z. Mustafa në vijim parashtroi disa pika në apelin e tij

1 në të cilat kundërshton konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje
2 me pranueshmërinë e provave të ndryshme dhe mbështetjen e
3 Trupit Gjykues në to në aktgjykim. Këto kundërshtime
4 përfshihen në Nënpiikat 1B, 1C, 1D, 1E dhe 1N të apelit.

5 Së pari, në Nënpiikën 1B, z. Mustafa kundërshtoi pranimin
6 si provë prej Trupit Gjykues të deklaratës së tij dhënë Zyrës
7 së Prokurorit të Specializuar ose ZPS-së, dhe mbështetjen e
8 Trupit Gjykues në të me pretendimin se ishte shkelur neni 3 i
9 Ligjit dhe rregulla 132 e Rregullores, si dhe e drejta e tij
10 për të mos inkriminuar veten.

11 Paneli i Apelit konstaton se deklarata e tij si i dyshuar
12 u bë përputhje ne nenin 38(3) (a) dhe (b) të Ligjit dhe
13 rregullën 43 të Rregullores të cilat përcaktojnë të drejtën e
14 të dyshuarve para Dhomave të Specializuara.

15 Paneli i Apelit gjykoi se z. Mustafa u informua në
16 mënyrën e duhur për të drejtat e tij si person i dyshuar dhe
17 se informacioni që mori z. Mustafa përmbush kriteret e nenit
18 38(3) (a) dhe (b) të Ligjit.

19 Paneli më tej konstaton se, për arsyet e shtjelluara në
20 aktgjykimin e apelit z. Mustafa nuk ka vërtetuar se pranimi i
21 deklaratës së tij si i dyshuar ka shkelur të drejtën e tij për
22 të mos inkriminuar veten, të mbrojtur nga neni 31 i
23 Kushtetutës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të
24 Drejtat e Njeriut apo se Trupi Gjykues gaboi që u mbështet në
25 të.

1 Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të
2 vërtetojë se Trupi Gjykses ka gabuar dhe për rrjedhojë rrëzon
3 Nënrikën 1B të apelit të tij.

4 Së dyti, në Nënrikën 1C të apelit, z. Mustafa kundërshtoi
5 pranimin si provë prej Trupit Gjykses të identifikimit të tij
6 prej Dëshmitarit W01679 në sallën e gjyqit dhe mbështetjen e
7 Trupit Gjykses në këtë identifikim me pretendimin se
8 identifikimi ishte bërë në mënyrë të parregullt dhe për
9 rrjedhojë duhet të ishte përjashtuar në bazë të rregullës 138
10 të Rregullores.

11 Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa ka humbur të
12 drejtën për të kundërshtuar në kuadër të apelit pranueshmërinë
13 e identifikimit, pasi ai nuk e ngriti këtë kundërshtim gjatë
14 vetë gjyqimit dhe nuk provoi ekzistencën e rrethanave të
15 posaçme që do të përlligjnin shqyrtimin e parashtrimeve të tij
16 për herë të parë në apel.

17 Gjithashtu, Paneli nuk konstaton gabim në mbështetjen
18 prej Trupit Gjykses në identifikimin e z. Mustafa prej
19 dëshmitarit dhe rrjedhimisht rrëzon Nënrikën 1C të apelit.

20 Tani në lidhje me kundërshtimin e z. Mustafa paraqitur në
21 Pikën 1D të apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa
22 nuk ka vërtetuar se Trupi Gjykses gaboi që pranoi si provë ose
23 që u mbështet në prova materiale të quajtur "lista e të
24 burgosurve". Paneli gjykon se Trupi Gjykses konstatoi, tregues
25 të mjaftueshëm të autenticitetit të këtij dokument për

1 mbështetshmëri. Paneli gjithashtu konstaton për arsyet e
2 parashtruara në aktgjykimin e apelit se Trupi Gjykses u
3 mbështet në këtë dokument thjesht si konfirmim për prova të
4 tjera që mbështesnin konstatimin e vet në lidhje me praninë e
5 z. Mustafa në kompleksin e ndalimit në Zllash. Rrjedhimisht,
6 Paneli rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa në Nënrikën 1D të
7 apelit.

8 Në vijim, Paneli i Apelit trajton kundërshtimin e z.
9 Mustafa në Nënrikën 1E të apelit ndaj pranimin si prova prej
10 Trupit Gjykses të deklaratave me shkrim të disa dëshmitarëve
11 dhe mbështetjen e Trupit Gjykses në to në bazë të rregullave
12 153 dhe 155 të Rregullores si dhe të deklaratave të bazuara në
13 thëniet e të tjerëve të një personi tjetër.

14 Paneli i Apelit konstaton se, në lidhje me deklaratën e
15 Dëshmitarit W0464,8 z. Mustafa nuk ka arritur të vërtetojë se
16 Trupi Gjykses gaboi që u mbështet që u mbështet në deklaratën
17 e këtij dëshmitari për faktin se Trupi Gjykses në konstatimet
18 e veta nuk u mbështet në asnjë pjesë të deklaratës të
19 kundërshtuar.

20 Paneli gjithashtu konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur
21 të vërtetojë se Trupi Gjykses gaboi që pranoi si provë
22 deklaratën e Dëshmitarit W04712 dhe gaboi në vlerësimin e saj
23 në të cilën Trupi Gjykses u mbështet për aq sa ajo deklaratë u
24 konfirmuar nga prova të tjera të besueshme dhe mbështetëse.

25 Sa u përket deklaratave të bazuara në thëniet e të

1 tjerëve, siç shtjellohet më tej në aktgjykimin e apelit,
2 Paneli i Apelit nuk konstaton gabim në vlerësimin dhe
3 mbështetjen e Trupit Gjykses në këto deklaratata.

4 Paneli i Apelit gjithashtu konstaton se Trupi Gjykses nuk
5 u dha peshë të tepruar këtyre deklaratave, por u mbështet në
6 to si prova konfirmuese të dëshmimeve të tjera gojore.

7 Si përfundim, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e
8 paraqitura nga z. Mustafa në Nënrikën 1E të apelit ndaj
9 konstatimeve të Trupit Gjykses.

10 Së fundi, në Nënrikën 1N të apelit, z. Mustafa
11 kundërshtoi pranimin si prova të akt-ekspertizave mjekësore në
12 lidhje me viktimën 08/05 dhe 09/05 sipas rregullës 132 të
13 Rregullores.

14 Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa ka humbur të
15 drejtën për ta kundërshtuar këtë pikë në apel pasi ai nuk e
16 ngriti këtë kundërshtim gjatë vetë gjykimit, as nuk provoi
17 ekzistencën e rrethanave të posaçme që do të përlligjnin
18 shqyrtimin e parashtrimeve të tij për herë të parë në apel,
19 dhe rrjedhimisht e rrëzon këtë kundërshtim.

20 Në vijim, në Nënrikën 2A, 2B, 2C, 2D, 2E, 2F dhe 2H të
21 apelit, z. Mustafa pretendon disa gabime faktike në lidhje me
22 konstatimet e Trupit Gjykses se krimet për të cilat u ngritën
23 akuzat ishin kryer në kompleksin e ndalimit në Zllash.

24 Së pari, në lidhje me argumentin e z. Mustafa se Trupi
25 Gjykses e etiketoi në mënyrë të parakohshme kompleksin e

1 shtëpive në Zllash si kompleks ndalimi, Paneli konstaton se
2 Trupat Gjykues kanë diskrecion të gjerë për t'i organizuar
3 aktgjykimet e tyre ashtu si i gjykojnë të arsyeshme dhe se z.
4 Mustafa nuk vërtetoi se Trupi Gjykues gaboi në ushtrimin e
5 diskrecionit të vet në këtë aspekt.

6 Së dyti, në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykues mbi
7 strehimin e BIA-s në kompleks, Paneli konstaton se në
8 kundërshtim me çka pretendon z. Mustafa Trupi Gjykues
9 ripërsëriti me saktësi thelbin e deklaratave të tij për
10 praninë e ushtarëve të BIA-s dhe të atij vetë në kompleks
11 gjatë periudhës përkatëse.

12 Në lidhje me argumentin e z. Mustafa se Trupi Gjykues
13 gaboi në konstatimin se kompleksi i ndalimit të Zllash
14 kontrollohej nga BIA, Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka
15 arritur të vërtetojë gabim në vlerësimin prej Trupit Gjykues
16 të provave mbi të cilat e bazoi këtë konstatim.

17 Z. Mustafa gjithashtu pretendon se Trupi Gjykues gaboi që
18 rrëzoi pretendimin e tij se ZPS-ja e mashtroi Mbrojtjen sepse
19 e ndryshoi qëndrimin e saj lidhur me ndërtesën apo ndërtesat
20 konkrete ku pretendohet se u mbajtën të ndaluara viktimat.

21 Paneli konstaton se argumentet e z. Mustafa janë të
22 pabaza duke qenë se në aktakuzë ndaj tij janë ngritur katër
23 akuza për krime lufte të kryera në kompleksin e ndalimit në
24 Zllash pa saktësuar se në cilën prej ndërtesave të kompleksit
25 ndodhën krimet e pretenduara.

1 Paneli në vijim do të trajtojë argumentin e z. Mustafa se
2 Trupi Gjykses gaboi në konstatimin se disa dëshmitarë të ZPS-
3 së mundën të identifikojnë vendin konkret të ndalimit. Paneli
4 konstaton se z. Mustafa në disa raste shtrembëroi dëshmitë e
5 dëshmitarëve. Paneli i Apelit gjithashtu konstaton se z.
6 Mustafa nuk ka arritur të tregojë se asnjë gjykses i arsyeshëm
7 faktesh nuk do të kishte mundur t'i pranonte dëshmitë e
8 dëshmitarëve që identifikuar vendin e ndalimit ose se
9 konstatimet e Trupit Gjykses janë tërësisht të gabuara.

10 Në lidhje me argumentin e z. Mustafa se ZPS-ja ishte
11 sugjeshive kur u tregoi dëshmitarëve fotografitë e kompleksit
12 të ndalimit në Zllash, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa
13 nuk arriti të paraqiste formalisht kundërshtim gjatë gjykimit
14 dhe rrjedhimisht Paneli konstaton se z. Mustafa e ka humbur të
15 drejtën për të ngritur këtë pretendim dhe rrëzon parashtrimet
16 e tij në lidhje me të.

17 Si përfundim, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e z.
18 Mustafa në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me
19 vendin e krimeve dhe këto janë Nënpiakat 2A pjesërisht, 2B, 2C,
20 2D, 2E pjesërisht, 2F dhe 2H pjesërisht.

21 Paneli i Apelit në vijim do të trajtojë kundërshtimet e
22 z. Mustafa në lidhje me metodologjinë që zbatoi Trupi Gjykses
23 për vlerësimin e dëshmitarëve. Këto kundërshtime lidhen me
24 pikën 1J, 2A, 2E, 2G, 2H, 2I, 2J, 2K, 2L, 2M dhe 2N të apelit.

25 Paraprakisht, Paneli vëren se shumica e parashtrimeve të

1 z. Mustafa në Pikat 1J, 2G, 2I, 2J, 2K, 2L dhe M të apelit nuk
2 përmbushën kriteret formale për apel. Paneli konstaton se
3 veçanërisht në Nënpiikat 2K dhe 2L dhe në lidhje me një
4 argument në Nënpiikën 2M, pjesërisht parashtrimet e z. Mustafa
5 në dosjen e apelit devijuan konsiderueshëm nga pikat përkatëse
6 të apelit të paraqitura në Njoftimin për Apel dhe rrjedhimisht
7 i rrëzon menjëherë këto pika.

8 Gjithashtu, sa i përket kundërshtimit të z. Mustafa ndaj
9 vlerësimit të Trupit Gjykues për dëshmitarët e Mbrojtjes
10 paraqitur në Pikën 1J të apelit, Paneli i Apelit konstaton se
11 z. Mustafa nuk identifikoi konkretisht asnjë dëshmitar dhe nuk
12 iu referua saktësisht pjesëve përkatëse në aktgjykim dhe për
13 arsyet e shtjelluara më gjerësisht në aktgjykimin e apelit
14 rrëzon parashtrimet e z. Mustafa në lidhje me këtë aspekt.

15 Në vijim Paneli do të trajtojë argumentin material të z.
16 Mustafa se Trupi Gjykues nuk vlerësoi në mënyrë të drejtë dhe
17 të paanshme dëshmitë e dëshmitarëve të Mbrojtjes kundrejt të
18 njëjtit standard që zbatoi kur vlerësoi dëshmitë e
19 dëshmitarëve të ZPS-së.

20 Paneli konstaton se Trupi Gjykues shtjelloi saktë
21 metodologjinë e vet lidhur me vlerësimin e provave në këtë
22 çështje gjyqësore veçanërisht lidhur me vlerësimin e
23 besueshmërisë së dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në dëshmitë
24 e tyre para se të mbështetej në dëshmitë e tyre sikurse
25 shtjellohet në aktgjykimin e apelit, Paneli konstaton se Trupi

1 Gjykues vlerësoi me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve duke
2 vënë në dukje çfarëdo mospërputhjes në dëshminë e një
3 dëshmitari dhe arsytet për pranimin ose mospranimin e asaj
4 dëshmie, në tërësi ose pjesërisht duke mbajtur parasysh ato
5 mospërputhje në dëshminë e një dëshmitari dhe arsytet për
6 pranimin ose mospranimin e asaj dëshmie në tërësi ose
7 pjesërisht duke mbajtur parasysh ato mospërputhje.

8 Më tej, sa i përket argumentit të z. Mustafa se Trupi
9 Gjykues gaboi që presupozoi se disa dëshmitarë patën -- më
10 tej, më falni, Paneli i Apelit do t'i trajtojë argumentet e z.
11 Mustafa se Trupi Gjykues gaboi që presupozoi se disa
12 dëshmitarë patën tendencë për të dhënë dëshmi të favorshme për
13 të akuzuarit dhe pafavorshme për ZPS-në.

14 Paneli konstaton se z. Mustafa nuk identifikoi asnjë
15 provë në mbështetje të këtij pretendimi të përgjithshëm për
16 njëanshmëri apo që tregonte se Trupi Gjykues nuk shqyrtoi në
17 mënyrë objektive apo siç duhet dëshmitë e dëshmitarëve që
18 dhanë dëshmi të favorshme për Mbrojtjen.

19 Paneli tani do të trajtojë argumentin e z. Mustafa se
20 Trupi Gjykues gaboi që nuk mori parasysh dëshmitë gojore të
21 dëshmitarëve të favorshme për Mbrojtjen për arsye jorelevante.

22 Së pari, Paneli vëren se në kundërshtim me pretendimin e
23 z. Mustafa kur vlerësoi besueshmërinë e dëshmitarëve, Trupi
24 Gjykues shqyrtoi dëshmitë e tyre duke u bazuar në faktet dhe
25 ngjarjet për të cilat ishin thirrur të dëshmonin.

1 Së dyti, Paneli gjykon se faktorët e tjerët që mori
2 parasysh Trupi Gjykes si lidhjet e ngushta me UÇK-në dhe/ose
3 të akuzuarin njëanshmëria e shprehur nga Dhomave të
4 Specializuara ose ZPS-së, treguesit e përshtatjes së dëshmimeve
5 apo harresat, janë faktorë relevantë për besueshmërinë e
6 dëshmitarëve dhe marrja parasysh e tyre mbështetet nga
7 jurisprudenca. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon kundërshtimet e z.
8 Mustafa në këtë aspekt.

9 Paneli, gjithashtu rrëzon argumentin e z. Mustafa se i
10 vetmi faktor relevant për vlerësimin e besueshmërisë është dhe
11 citoj "nëse dëshmitari është ose nuk është duke e thënë të
12 vërtetën". Në lidhje me këtë Paneli gjykon se Trupi Gjykes ka
13 në kompetencë të plotë diskrecionale në lidhje me peshën dhe
14 besueshmërinë e duhur që i akordohet një dëshmitari.

15 Mbi bazën e kësaj, Paneli konstatoi se z. Mustafa nuk ka
16 arritur të provojë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykes për
17 besueshmërinë e dëshmitarëve që dhanë dëshmi të favorshme për
18 Mbrojtjen dhe mbështetshmërinë në dëshmitë e tyre, dhe
19 rrjedhimisht rrëzon kundërshtimet e tjera përkatëse që z.
20 Mustafa parashton në pjesën e mbetur të Nënplikave, 1J, 2A,
21 2E, 2G, 2H, 2I, 2J, 2N dhe pjesërisht 2M të apelit.

22 Z. Mustafa gjithashtu paraqiti disa pika në apel ku
23 kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykes lidhur me
24 besueshmërinë e disa dëshmitarëve dhe mbështetshmërinë në
25 dëshmitë e tyre. Këto janë Nënplikat 1F, 1G, 1H, 1I dhe 2P të

1 apelit. Për arsyet e shtjelluara në aktgjykimin e apelit
2 Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa në këto pika
3 të apelit mbi bazën se argumentet janë jashtë kuadrit të
4 Njoftimit për Apel, z. Mustafa ka humbur të drejtën për ta
5 kundërshtuar këtë aspekt në apel meqë nuk e ka ngritur në
6 gjykim ose z. Mustafa nuk ka arritur të provojë se Trupi
7 Gjykses gaboi që u mbështet në këta dëshmitarë apo i vlerësoi
8 gabimisht ata.

9 Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimin e z.
10 Mustafa në Nënplikën 1K të apelit në lidhje me vlerësimin prej
11 Trupit Gjykses të besueshmërisë së një dëshmitari.

12 Duke pretenduar se Trupi Gjykses gaboi që nuk mori
13 parasysh motivin financiar të dëshmitarit për të dëshmuar dhe
14 që nuk e lejoi Mbrojtjen t'i bënte pyetje dëshmitarit në
15 lidhje me këtë, duke shkelur të drejtën e tij të barazisë
16 midis palëve.

17 Paneli i Apelit gjykon se z. Mustafa nuk ka arritur të
18 provojë gabim meqenëse Trupi Gjykses vlerësoi në hollësi
19 besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në dëshminë e
20 tij duke mbajtur parasysh faktorë relevantë.

21 Paneli gjithashtu konstaton se Trupi Gjykses nuk e pengoi
22 z. Mustafa që të kundërshtonte besueshmërinë e këtij
23 dëshmitari, por vendosi kufizime të përshtatshme në lidhje me
24 kuadrin e pyetjeve të tij për dëshmitarin. Prandaj, Paneli i
25 Apelit rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa në lidhje me këtë

1 aspekt.

2 Së fundi, në Nënplikën 2P të apelit, z. Mustafa
3 kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykses për dëshminë gojore të
4 një dëshmitari që u mbështet në atë dëshmi kur nxori
5 konstatimet në lidhje me vendin e ndalimit të viktimës së
6 vrasjes së paligjshme dhe praninë e z. Mustafa në kompleksin e
7 ndalimit në Zllash gjatë asaj periudhe.

8 Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të
9 provojë gabim në vlerësimin e Trupit Gjykses meqenëse
10 konstatimet e Trupit Gjykses pasqyrojnë saktë dëshminë gojore
11 të dëshmitarit, dhe për më tepër Trupi Gjykses nënvizoi me
12 kujdes mospërputhjet në dëshminë e dëshmitarit dhe u mbështet
13 në të vetëm për aq sa ai u konfirmua nga dëshmi të tjera.
14 Paneli i Apelit rrjedhimisht rrëzon Pikën 2P të apelit.

15 Tani do të trajtoj pretendimin për alibi të z. Mustafa.
16 Nënplikat 1L, 1M, të apelit dhe në pjesën e mbetur në Nënplikave
17 2M dhe 2O të apelit, z. Mustafa kundërshtoi mosmarrjen
18 parasysht nga Trupi Gjykses të mbrojtjes përmes alibisë në
19 lidhje me praninë e tij në vendin e krimeve gjatë periudhës
20 përkatëse.

21 Së pari, Paneli i Apelit nuk konstaton asnjë gabim
22 juridik sa i përket standardit për vlerësimin e mbrojtjes
23 përmes alibisë të përcaktuar nga Trupi Gjykses që mbështetës
24 gjerësisht nga jurisprudenca. Konkretisht, Trupi Gjykses
25 theksoi se nuk është e nevojshme që i akuzuari të vërtetojë

1 alibinë jashtë dyshimit të arsyeshëm dhe me të drejtë shqyrtoi
2 nëse provat e alibisë mund të vërtetonin *prima facie* praninë e
3 z. Mustafa në vende të tjera dhe jo në Zllash për të krijuar
4 dyshim të arsyeshëm lidhur me provat e ZPS-së në këtë rast.

5 Sa i përket kundërshtimeve të z. Mustafa lidhur me
6 konstatimet faktike të Trupit Gjykses, Paneli i Apelit
7 konstaton sikurse shpjegohet me më shumë hollësi në
8 aktgjykimin e apelit se Trupi Gjykses nuk gaboi në konstatimet
9 faktike të tij lidhur me alibinë e z. Mustafa. Bazuar sa më
10 lart, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa ndaj
11 konstatime të Trupit Gjykses lidhur me Nënpiakat 1L, 1M dhe 2O
12 dhe pjesën e mbetur të Nënpiakës 2M të apelit.

13 Paneli në vijim do të bëjë një përmbledhje të
14 konstatimeve të veta lidhur me këndvështrimet e z. Mustafa të
15 paraqitura në Pikat 3, 4, dhe 5 të apelit.

16 Z. Mustafa, kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykses
17 lidhur me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të krimit të
18 luftës së vrasjes së paligjshme sipas nenit 14(1)(c) dhe (e)
19 të Ligjit. Mbi të cilat u bazua verdikti i fajësisë për Pikën
20 4 të aktakuzës për vrasjen e paligjshme të viktimës së vrasjes
21 së paligjshme afërsisht midis 19 prill 1999 ose rreth kësaj
22 date dhe fundit të prillit 1999.

23 Paneli së pari do të trajtojë pretendimet për gabime
24 lidhur me veprimin e fajshëm të vrasjes së paligjshme të
25 paraqitura në Pikat 3 dhe 4 të apelit.

1 Sa i takon kundërshtimeve faktike të z. Mustafa lidhur me
2 shkakësinë e vrasjes së paligjshme, Paneli rikujton se Trupit
3 Gjykses nuk mund t'i veçonte asnjë shkak faktik të vetëm për
4 vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme. Trupi Gjykses
5 konstatoi se vdekja ishte pasojë e kombinimit të keqtrajtimit
6 të rëndë të shkaktuar nga anëtarët e BIA-s që e mbajtën të
7 ndaluar në kompleksin e ndalimit në Zllash duke i shkaktuar
8 atij lëndime të rënda trupore, refuzimit të ndihmës mjekësore
9 nga anëtarët e BIA-s që e mbajtën të ndaluar, dhe plagë nga
10 armë zjarri.

11 Sa i përket shkakësisë juridike, Paneli konstaton se
12 Trupi Gjykses zbatoi saktë standardin e kontributit të
13 konsiderueshëm i cili është përcaktuar qartë në jurisprudencën
14 e gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë dhe të cilin si të
15 tillë z. Mustafa nuk e kundërshton.

16 Trupi Gjykses konstatoi se keqtrajtimi i rëndë dhe
17 refuzimi i ndihmës mjekësore si faktor shkakësor iu atribuan
18 vetëm z. Mustafa dhe vartësve të tij të BIA-s dhe se ishin
19 shkaqe të konsiderueshme të vdekjes të viktimës së vrasjes së
20 paligjshme.

21 Sa i përket vrimave të plumbave në trupin e viktimës së
22 paligjshme, Trupi Gjykses konstatoi se ekziston dyshimi i
23 arsyeshëm nëse ato mund të atribuoheshin anëtarëve të BIA-s
24 ose forcave serbe. Paneli i Apelit gjykon se duke marrë
25 parasysh këtë paqartësi dhe duke zbatuar pranimin *informacion*

1 *dubio pro reo*, pra në qoftë se ke dyshim, Trupi Gjykes me të
2 drejtë supozoi skenarin faktik më të favorshëm për z. Mustafa
3 - pra, që forcat serbe shtinë ndaj viktimës së vrasjes së
4 paligjshme.

5 Për pasojë, dhe me qëllimin e atribuimit të drejtë të
6 përgjegjësisë për vrasjen e viktimës së vrasjes së paligjshme,
7 Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykes duhet të kishte
8 vlerësuar gjithashtu nëse të shtënat që u supozuan se erdhën
9 nga forcat serbe përbënin ndërhyrje relevante të një pale të
10 tretë që ndërpret zinxhirin e shkakësisë midis z. Mustafa dhe
11 vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme.

12 Paneli fitoi njohuri kyçe në lidhje me zbatimin e duhur
13 të parimit *novus actus interveniens*, pra një akt i ri
14 ndërhyrës, i cili përshkruan pasojat e ndërhyrjeve të tilla të
15 palëve të treta mbi shkakësinë juridike duke u bazuar në
16 analizën e disa juridiksioneve të së drejtës civile dhe anglo-
17 saksone. Paneli arrin në përfundimin se një *novus actus i*
18 tillë është relevant vetëm nëse ndërpret zinxhirin e
19 shkakësisë në rrethana ngushtësisht të përcaktuara;
20 përkatësisht kur ndërhyrja nuk është e parashikueshme ose nuk
21 është pjesë e sferës së rrezikut të parë që lidhet të
22 akuzuarin dhe që krijon një rrezik krejtësisht të ri që është
23 aq i madh sa e bën të papërfillshëm rrezikun e parë.

24 Paneli i Apelit gjykon se megjithëse nuk shqyrtoi
25 shprehimisht parim *novus actus interveniens*, ai e bëri këtë në

1 mënyrë të nënkuptuar, dhe rrjedhimisht nuk gaboi lidhur me të,
2 në lidhje me të.

3 Kjo sepse për mendimin e Panelit të Apelit konstatimet e
4 Trupit Gjykues mbështesin përfundimin se të shtënat që u
5 supozuan se erdhën nga forcat serbe, nuk përbëjnë *novus actus*
6 relevant, në kuptimin e mësipërm të ndërprerjes së zinxhirit
7 shkakësor midis sjelljes së z. Mustafa dhe vdekjes së vdekjes
8 së viktimës së vrasjes së paligjshme.

9 Paneli i Apelit gjithashtu rrëzon argumentin e z. Mustafa
10 se vdekja për shkak të keqtrajtimit ose refuzimit të ndihmës
11 mjekësore mund të mos përbëjë vrasje të paligjshme.

12 Paneli gjykon se është përcaktuar tashmë në një
13 jurisprudencën e gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë se
14 vdekja mund të ndodhë si rezultat i një veprimi ose
15 mosveprimi, duke i plotësuar kështu kushtet për vrasje të
16 paligjshme se keqtrajtimi dhe refuzimi i ndihmës mjekësore në
17 këtë kuptim nuk dallojnë nga asnjë veprim apo mosveprim
18 tjetër.

19 Paneli i Apelit gjithashtu rrëzon pretendimin e z.
20 Mustafa se duhej bërë konstatim në lidhje me kohën e vrasjes
21 së viktimës së vrasjes së paligjshme. Paneli konstaton, për
22 arsyet e shtjelluara në aktgjykimin e apelit se megjithëse
23 përcaktimi i saktë i kohës së vdekjes mund të jetë i nevojshëm
24 në rrethana të caktuara faktike për t'i atribuuar përgjegjësi
25 të akuzuarit. Në rastin konkret, nuk ishte nevojë për një

1 përcaktim më të saktë të kohës së vdekjes sesa ai i dhënë
2 gjatë gjykimit.

3 Sa i përket argumentit të z. Mustafa në lidhje me
4 zhvarrosjen dhe ekzaminimin post-mortem të varrit që besohet
5 se ishte i viktimës së vrasjes së paligjshme, Paneli i Apelit
6 konstaton se z. Mustafa nuk e ngriti këtë pikë gjatë gjykimit
7 dhe rrjedhimisht ka humbur të drejtën për ta kundërshtuar atë
8 në apel. Për këtë arsye Paneli i Apelit e rrëzon këtë
9 argument.

10 Tani Paneli do të trajtojë pretendimet e z. Mustafa për
11 gabime faktike në lidhje me veprimin e fajshëm të vrasjes së
12 paligjshme.

13 Së pari, Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të
14 provojë se Trupi Gjykses nuk konstatoi jashtë dyshimit të
15 arsyeshëm se viktima e vrasjes së paligjshme nuk qe në gjendje
16 të qëndronte në këmbë kur u pa për herë të fundit nga të
17 ndaluarit e tjerë.

18 Paneli gjithashtu konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur
19 të provojë se një konstatim i tillë ishte i domosdoshëm për
20 përcaktimin e fajësisë së tij dhe rrjedhimisht duhej të ishte
21 konstatuar se ishte provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

22 Po kështu, z. Mustafa nuk ka arritur të provojë mangësi
23 në provat mbi të cilat u mbështet Trupi Gjykses për këtë
24 qëllim.

25 Së dyti, Paneli gjykon se z. Mustafa shpërfilli

1 referencat e hollësishme për provat në aktgjykim të cilat
2 mbështesin përfundimet e Trupit Gjykses se viktima e vrasjes
3 së paligjshme vdiq nga keqtrajtimi dhe refuzimi i ndihmës
4 mjekësore nga anëtarët e BIA-s; së dyti, nuk u evakua; dhe së
5 treti u qëllua me plumba.

6 Së treti, ashtu sikurse shtjellohet në aktgjykimin e
7 apelit Paneli konstaton se përfundimi i Trupit Gjykses se
8 vendimin për të mos liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së
9 paligjshme nga kompleksi i ndalimit në Zllash me afrimin e
10 forcave serbe, mund ta kishte marrë vetëm i akuzuari, u
11 mbështet edhe nga provat dhe rrjedhimisht ai rrëzon
12 pretendimet e z. Mustafa për gabime në lidhje me këtë aspekt.

13 Në përfundim, dhe për arsyet e paraqitura në aktgjykimin
14 e apelit. Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të
15 provojë se Trupi Gjykses bëri gabim juridik ose faktik që
16 konstatoi se sjellja e tij përmbushte veprimin e fajshëm
17 vrasjes së paligjshme dhe rrëzon Pikat 3 dhe 4 të apelit të z.
18 Mustafa.

19 Paneli tani do të trajtojë pretendimet për gabimet në
20 konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me Pikën 5 të aktakuzës.

21 Paraprakisht, Paneli rikujton se Trupi Gjykses konstatoi
22 se z. Mustafa "kishte synimin" ta vriste viktimën e vrasjes së
23 paligjshme.

24 Sikurse shtjellohet në hollësi në aktgjykimin e apelit,
25 megjithatë Trupi Gjykses mund të kishte shprehur më qartë

1 llojin e synimeve që kishte z. Mustafa sipas Trupit Gjykues si
2 dhe përkufizimin e saktë të atij synimi, sipas Paneli i Apelit
3 konstatimi i Trupit Gjykues ishte që z. Mustafa kishte synim
4 të drejtpërdrejtë për vrasje të paligjshme.

5 Sa i përket argumentit të z. Mustafa se Trupi Gjykues
6 zbatoi standardin e gabuar të synimit kriminal për krimin e
7 luftës të vrasjes së paligjshme, Paneli gjykon se standardi i
8 zbatueshëm i synimit kriminal është i njëjtë, pavarësisht nëse
9 krimi është kryer përmes veprimit apo mosveprimit.

10 Paneli tani do të trajtojë argumentet e z. Mustafa se
11 Trupi Gjykues gaboi që arriti në përfundimin se vendimi për të
12 mos të liruar apo evakuuar viktimën e vrasjes së paligjshme
13 nga kompleksi i ndalimit në Zllash me afrimin e forcave serbe
14 efektivisht ishte i barabartë me një vendim për vrasjen e tij
15 sepse nuk u provua se ai kishte dijeni për gjendjen e viktimës
16 së vrasjes së paligjshme.

17 Paneli vëren se Trupi Gjykues nuk bëri shprehimisht
18 konstatim se z. Mustafa kishte dijeni për gjendjen e viktimës
19 së vrasjes së paligjshme. Megjithatë, Paneli gjykon se dijenia
20 dhe synimi logjikisht mund të deduktohen nga faktet dhe
21 rrethanat relevante për të cilat Trupi Gjykues ka bërë
22 konstatim dhe të cilat trajtohen me hollësi në aktgjykimin e
23 apelit. Paneli konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të
24 provojë se në një mungesë të një konstatimi të tillë të
25 formuluar shprehimisht, asnjë Trup Gjykues i arsyeshëm nuk

1 mund të kishte arritur në përfundimin e Trupit Gjykues se
2 vendimi për të mos e liruar apo evakuuar viktimës së vrasjes
3 së paligjshme faktikisht ishte i barabartë me një vendim për
4 vrasjen e tij.

5 Rrjedhimisht, dhe bazuar në arsyet e shtjelluara në
6 aktgjykimin e apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa
7 nuk ka arritur të provojë gabim në konstatimet e Trupit
8 Gjykues lidhur me synimin kriminal të krimit të luftës të
9 vrasjes së paligjshme, dhe për këtë arsye rrëzon Pikën 5 të
10 apelit dhe kundërshtimet e z. Mustafa ndaj konstatimeve të
11 Trupit Gjykues lidhur me Pikën 4 të aktakuzës.

12 Në lidhje me Pikat 6 dhe 7 të apelit, z. Mustafa
13 kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me veprimin
14 e fajshëm dhe synimin kriminal të krimit të luftës së torturës
15 sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit, dhe argumentoi se ishte gabuar
16 shpallja e tij fajtoj për torturimin e të paktën gjashtë
17 personave, ndërkohë që Trupi Gjykues konstatoi vetëm se ai
18 mori pjesë personalisht në torturimin e dy personave.

19 Paneli do të trajtojë së pari argumentin e z. Mustafa se
20 elementet e veprimit të fajshëm të torturës nuk u vërtetuan
21 sepse dëshmitë e dëshmitarë për keqtrajtim fizik të tyre nuk u
22 konfirmuan nga dëshmitarë të tjerë.

23 Paneli konstaton se z. Mustafa e keqinterpreton
24 aktgjykimin dhe e shpërfill faktin se të gjithë dëshmitarët që
25 pretendohet se ishin keqtrajtuar individualisht dëshmuan

1 gjithashtu për keqtrajtimin e pësuar nga të tjerët, përfshirë
2 edhe në praninë e atyre. Po kështu, z. Mustafa shpërfill
3 faktin se Trupi Gjykses konstatoi që keqtrajtimi fizik nuk
4 ishte e vetmja formë torture që pësuan të ndaluarit, por se
5 ata ishin keqtrajtuar edhe psikologjikisht dhe ishin mbajtur
6 në kushte çnjerëzore gjatë të gjithë kohës së ndalimit në
7 kompleksin e ndalimit në Zllash. Dhe rrjedhimisht Paneli
8 rrëzon argumentet e z. Mustafa.

9 Në vijim Paneli do të trajtojë argumentin e z. Mustafa
10 lidhur me synimin kriminal të torturës si krim lufte,
11 konkretisht që Trupi Gjykses nuk konstatoi, por vetëm supozoi
12 qëllimin e nevojshëm të keqtrajtimit.

13 Paneli i Apelit konstaton se përfundimi i Trupit Gjykses
14 se qëllimi konkret i keqtrajtimit ishte vërtetuar, mbështetet
15 nga dëshmitë e një numri dëshmitarësh okularë dhe u arsyetua
16 mjaftueshëm.

17 Së fundi, Paneli do të trajtojë argumentin e z. Mustafa
18 në Pikën 7 të apelit se Trupi Gjykses gaboi kur e shpalli
19 fajtor për torturimin e të paktën gjashtë personave, ndërkohë
20 që Trupi Gjykses konstatoi vetëm se ai mori pjesë personalisht
21 në torturimin e dy personave. Paneli konstaton se z. Mustafa
22 nuk ka arritur të provojë gabim në konstatimet e Trupit
23 Gjykses sa i përket verdiktit të fajësisë për krimin e luftës
24 së torturës, në bazë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët.

25 Në përfundim, Paneli rrëzon Pikat -- rrëzon kundërshtimet

1 e z. Mustafa ndaj konstatimeve të Trupit Gjykues në lidhje me
2 Pikën 3, dhe rrëzon Pikat 6 dhe 7 të apelit.

3 Në Pikën 8 të apelit, z. Mustafa kundërshton konstatimet
4 e Trupit Gjykues se ndalimi arbitrar i kryer në një konflikt
5 të armatosur jo-ndërkombëtar përbën krim lufte sipas nenit
6 14(1)(c) të këtij Ligjit.

7 Paneli vëren se z. Mustafa, në fakt, ka kundërshtuar dy
8 vendime të mëparshme të Dhomës së Gjykatës së Apelit mbi të
9 cilat i bazoi konstatimet e veta Trupi Gjykues. Paneli
10 konstaton se z. Mustafa nuk ka arritur të provojë gabim
11 juridik në vendimet e Dhomës së Gjykatës së Apelit dhe për
12 këtë arsye nuk ka provuar ekzistencën e arsyeve bindëse për të
13 devijuar nga ato vendime, në interes të drejtësisë.

14 Paneli rrëzon gjithashtu kërkesën e z. Mustafa për t'ia
15 referuar këtë pikë për shqyrtim Dhomës së Specializuar të
16 Gjykatës Kushtetuese.

17 Në përfundim, Paneli i Apelit konstaton se z. Mustafa nuk
18 ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykues gaboi në lidhje me
19 fazën juridike të krimit të luftës të ndalimit arbitrar dhe
20 rrëzon kundërshtimet e z. Mustafa ndaj konstatimeve të Trupit
21 Gjykues në lidhje me Pikën 1 të aktakuzës dhe rrëzon Pikën 8
22 të apelit.

23 Së fundi, në Pikën 9 të apelit, z. Mustafa kundërshtoi
24 konstatimet e Trupit Gjykues lidhur me dënimin me një 26
25 burgim për tre pikat e aktakuzës për të cilat ai u shpall

1 fjalor -- u shpall fajtor.

2 Së pari, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk
3 gaboi në balancimin e rrethanave personale të z. Mustafa
4 kundrejt llojit dhe peshës së krimeve dhe kontributit të tij
5 në krimet për të cilat u shpall fajtor. Në fakt, Trupi Gjykses
6 ka detyrimin që ta bëjë këtë në bazë të kornizës juridike të
7 Dhomave të Specializuara.

8 Për më tepër, Paneli i Apelit konstaton se, në
9 kundërshtim me pretendimet e z. Mustafa, Trupi Gjykses nuk e
10 konsideroi mungesën e rrethanave lehtësuese si faktor rëndues
11 dhe nuk e përdori peshën e krimeve si rrethanë rënduese. në
12 lidhje me duke patur parasysh diskrecionin e gjerë që ka Trupi
13 Gjykses në dhënien e dënimit, Paneli i Apelit nuk konstaton
14 gabim në faktin se Trupi Gjykses refuzoi t'u jepte peshë të
15 qenësishme rrethanave personale të tij.

16 Paneli i Apelit gjithashtu rrëzon argumentin e z. Mustafa
17 se nuk do të ishte e mundur t'i paraqiste në gjykim, sepse
18 atij iu dhanë mundësi dhe udhëzime të shumta për ta bërë këtë
19 dhe gjithsesi Paneli gjykon se Trupi Gjykses i mori parasysh
20 ato *proprio motu*, pra me nismën e vet. Paneli i Apelit
21 gjithashtu rrëzon pretendimin se Trupi Gjykses gaboi që dha
22 një dënim me burgim për të cilin z. Mustafa pretendon se mund
23 të tejkalojë jetëgjatësinë e pritshme të tij sepse ky
24 pretendim kundërshtohet nga korniza juridike e Dhomave të
25 Specializuara që lejon dhënie dënim deri me burgim të

1 përjetshëm, si dhe nga jurisprudenca ndërkombëtare.

2 Së fundi, Paneli i Apelit do të trajtojë argumentet e z.
3 Mustafa lidhur me zbatimin e parimit *lex mitior*, dhe
4 argumentin e tij se dënimi ishte tejet i gjatë.

5 Në lidhje me këtë Paneli i Apelit konstaton së pari se
6 Trupi Gjykses konstatoi me të drejtë se nuk ishte i detyruar
7 të zbatonte shkallëzimin e dënimeve në fuqi sipas
8 legjislacionit të Kosovës në kohën e kryerjes së krimeve, dhe
9 as ndonjë shkallëzim dënimesh më të butë të zbatueshëm më
10 vonë. Por se në vend të kësaj duhej t'i merrte parasysh ato në
11 kuadër të kornizës juridike të Dhomave të Specializuara.

12 Për arsyet që shpjegohen më në hollësi në aktgjykimin e
13 apelit, Paneli i Apelit konstaton se parimi *lex mitior* nuk
14 është i zbatueshëm në raport me shkallëzimet e dënimeve sipas
15 legjislacionit shtetëror dhe se nuk ka mospajtueshmëri midis
16 kornizës juridike të Dhomave të Specializuara dhe Kushtetutës
17 së Kosovës. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon edhe kërkesën e z.
18 Mustafa për t'i referuar këtë pikë për shqyrtim Dhomës së
19 Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

20 Megjithatë, Paneli i Apelit konstaton se analiza që i
21 bëri Trupi Gjykses sistemit të dënimeve sipas legjislacionit
22 shtetëror është e pamjaftueshme për përmbushjen e detyrimit të
23 tij për të marrë parasysh shkallëzimet e dënimeve sipas atij
24 legjislacioni. Për këtë qëllim, dhe lidhur me argumentin e z.
25 Mustafa që dënimi i tij është i tepruar, Paneli i Apelit ka

1 analizuar jurisprudencën ndërkombëtare dhe të Kosovës në
2 lidhje me krime lufte të krahasueshme me ato për të cilat u
3 dënua z. Mustafa. Në kryerjen e kësaj analiza, Paneli i Apelit
4 ishte i vetëdijshëm për faktin se dënimet nuk mund të
5 zhvendosen lehtë nga një çështje gjyqësore në tjetrën për
6 shkak të faktorëve konkretë të çështjeve gjyqësore në dhënien
7 e dënimit.

8 Paneli i Apelit konstaton se në çështjet e gjykuara në
9 tribunale ndërkombëtare dhe në gjykatat e Kosovës lidhur me
10 krime lufte të krahasueshme, pra, me ato për të cilat u dënua
11 z. Mustafa, dënimet e dhëna ishin më të shkurtra se dënimi i
12 z. Mustafa. Ndonëse plotësisht i vetëdijshëm për diskrecionin
13 e gjerë të Trupit Gjykses në dhënien e dënimit Paneli
14 konstaton se mospërputhja midis dënimit të z. Mustafa dhe
15 dënimeve që analizoi Paneli, tregon se Trupi Gjykses i
16 tejkaloi kufijtë e diskrecionit në këtë rast. Rrjedhimisht,
17 Paneli i Apelit gjykon se duke i dhënë z. Mustafa dënime
18 jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me një varg
19 dënimesh të dhëna në rrethana të ngjashme për vepra penale të
20 ngjashme, Trupi Gjykses ka kryer një gabim të dallueshëm në
21 dënimin e dhënë.

22 Për arsye që shtjellohen në aktgjykimin e apelit, Paneli
23 i Apelit rrjedhimisht e gjykon të përshtatshme që dënimet
24 individuale që iu dhanë z. Mustafa t'i ulë në dënimet si
25 vijon: Së pari, tetë vjet burgim për Pikën 1 të aktakuzës,

1 krimi i luftës i ndalimit arbitrar i kryer kundër së paku
2 gjashtë personave; së dyti, 20 vjet për burgimin -- 20 vjet
3 burgim për Pikën 3 të aktakuzës, krimi i luftës së torturës, i
4 kryer kundër të paktën gjashtë personave; dhe së treti, 22
5 vjet burgim për Pikën 4 të aktakuzës, krimi i luftës i vrasjes
6 së paligjshme kryer një personi.

7 Në përputhje me këtë, Paneli i Apelit tani duhet të
8 përcaktojë gjithashtu në bazë të rregullës 163(4) së
9 Rregullores, një dënim të njehsuar që pasqyron tërësinë e
10 veprimtarisë kriminale të të akuzuarit që nuk është më pak i
11 rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo
12 akuzë. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit gjykon se një dënim
13 i njehsuar me 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar
14 në paraburgim që prej arrestimit të tij me 24 shtator 2020,
15 pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të z. Mustafa në
16 këtë çështje.

17 Paneli i Apelit vëren se konstatimet e veta në lidhje me
18 dënimin e z. Mustafa nuk ndikojnë në konstatimet e Trupit
19 Gjykues në urdhrin për zhdëmtim kundër z. Mustafa dhe thekson
20 se zvogëlimi i dënimeve të z. Mustafa nuk sugjeron aspak se
21 krimet për të cilat ai është shpallur fajtor dhe dënuar nuk
22 janë të rënda.

23 Bazuar në sa më lartë, Paneli i Apelit pranon pjesërisht
24 kundërshtimin e z. Mustafa ndaj konstatimeve të Trupit Gjykues
25 në lidhje me dënimin, dhe rrëzon pjesën e mbetur të Pikës 9 të

1 apelit.

2 Së fundi, Paneli i Apelit thekson se ka lënë fuqi
3 verdiktet e fajësisë së z. Mustafa për krimet e luftës,
4 ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, për të
5 cilat u konstatua se mbante përgjegjësi penale individuale.
6 Dhomat e Specializuara kanë juridiksion vetëm mbi individë jo
7 mbi grupe dhe organizata. Për këtë arsye, Paneli i Apelit
8 konstaton se as UÇK-ja as populli i Kosovës nuk ishin objekt i
9 këtij procesi gjyqësor dhe nuk mbahen përgjegjës apo fajtor
10 për këto krime.

11 Tani dua t'i kërkoj z. Mustafa të ngrihet në këmbë që të
12 lexoj tekstin e plotë të vendimit të apelit -- të aktgjyqimit
13 të apelit.

14 Vendimi është si më poshtë:

15 Për arsyet e lartpërmendura, pasi ka shqyrtuar të gjitha
16 argumentet e paraqitura nga palët dhe pjesëmarrësit, Paneli i
17 Gjykatës së Apelit, në bazë të nenit 46 të Ligjit dhe
18 rregullave 182 dhe 183 të Rregullores:

19 Miraton Nënpiakat 9F pjesërisht, 9H pjesërisht dhe 9K
20 pjesërisht të apelit të z. Mustafa;

21 Rrëzon të gjitha aspektet e tjera të apelit të z.
22 Mustafa;

23 Lë në fuqi verdiktin e fajësisë për z. Mustafa për krimin
24 e luftës së ndalimit arbitrar në bazë të neneve 14(1)(c)(i)
25 dhe 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës 1 të aktakuzës, krimin e

1 luftës të torturës në bazë të neneve 14(10(c)(i) dhe 16(1)(a)
2 të Ligjit sipas Pikës 3 të aktakuzës...

3 [Paneli i Apelit dhe Sekretari i Gjykatës
4 këshillohen]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Më falni.

6 Do të vazhdoj. S'e di ku e lashë tani.

7 Do ta filloj edhe një herë.

8 Më dëgjoni z. Mustafa?

9 APELUESI: Po, ju dëgjoj.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Pra, lë në
11 fuqi verdiktin e fajësisë për z. Mustafa për krimin e luftës
12 së ndalimit arbitrar në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe
13 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës 1 të aktakuzës, krimin e luftës
14 së torturës në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të
15 Ligjit sipas Pikës 3 të aktakuzës, dhe krimin e luftës së
16 vrasjes së paligjshme në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe
17 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës 4 të aktakuzës;

18 Anulon dënimin me 10 vjet burgim në lidhje me Pikën 1 të
19 aktakuzës dhe cakton një dënim me tetë vjet burgim;

20 Anulon dënimin me 22 vjet burgim në lidhje me Pikën 3 të
21 aktakuzës dhe cakton një dënim me 20 vjet burgim;

22 Anulon dënimin me 25 vjet burgim në lidhje me Pikën 4 të
23 aktakuzës dhe cakton një dënim me 22 vjet burgim;

24 Anulon dënimin e njehsuar me 26 vjet burgim për z.

25 Mustafa dhe cakton një dënim një njehsuar me 22 vjet për z.

1 Mustafa duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim

2 Vendos që ky aktgjykim të zbatohet me efekt të
3 menjëhershëm në bazë të rregullës 185(1) të Rregullores, dhe
4 urdhëron që në pajtim me nenin 50(1) të Ligjit dhe rregullën
5 166(3) të Rregullores, z. Mustafa të mbetet në paraburgimin e
6 Dhomave të Specializuara deri në finalizimin e masave për të
7 transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

8 Z. Mustafa, mund të uleni.

9 Zyra Administrative tani do të shpërndajë aktgjykimin e
10 apelit në formë elektronike.

11 Sekretar, ju lutem, mund të konfirmoni?

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Konfirmoj që parashtrimi
13 F38 i është shpërndarë palëve dhe F38 RED që është versioni
14 publik i redaktuar është vendosur në faqen e internetit.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

16 Faleminderit. Me këtë përfundon seanca e sotme.

17 Falënderoj pjesëmarrësit dhe Zyrën Administrative për
18 punën e tyre dhe për pjesëmarrjen sot. Falënderoj edhe
19 përkthyesit, teknikët, stenografët dhe ekipin e mbështetjes
20 ligjore për mbështetjen e tyre të shkëlqyer.

21 Seanca mbyllet.

22 --- Seanca mbyllet në orën 10.36

23

24

25